

Njoftim aplikimi për rinovim licence

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë se shoqëria “INFO-telecom” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Në mbledhjen e datës 15.01.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e kësaj licence.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me kërkesën për rinovim licence, brenda 10 (dhjetë) ditëve (nga data 16.01.2026 deri më 26.01.2026) pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.